



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Shpërthimi me 6 të lënduar në Lezhë, flet i afërm i familjes Kola: Sajmiri martonte nesër vajzën e vëllait! Fillimisht kujtova se u ça ndonjë gomë kamioni
- 2

VKM/ Shqipëria ngre Task-Forcën për Samitin e NATO-s 2027 në Tiranë, anëtarë nga Mbrojtja, SHISH e FAI! Ja detyrat për organizimin
- 3

Aeroporti i Vlorës/ MABCO dhe 2A Group takim me Ministrinë e Infrastrukturës, kompania e Pacollit: Na u la kohë të paraqesim propozimet për rifillimin e punës
- 4

'Shqipëria na bashkon', aktori Leonit Maloku në 'Minute Zero' Edhe kur Iuan Kosova me flamurin kuqezi festojmë
- 5

Tirana pa drejtues në zyrë, Kryeministria: Situata, pasojë e burgosjes së Veliajt! Kushtetuesja foli qartë, është kryetar! Cenohet marrja e shërbimeve

Kronikë

Dhunoi dhe kërcënoi bashkëshorten, arrestohet 67-vjeçari në Mat! Në banesë iu gjet automatik dhe 55 fishekë

Një 67-vjeçar u arrestua në Burrel pasi dyshohet se dhunoi dhe kërcënoi bashkëshorten. Gjatë kontrollit në banesë, policia gjeti dhe sekuestroi një armë automatike, 2 krehra dhe 55 fishekë.

Dhunoi dhe kërcënoi bashkëshorten, arrestohet 67-vjeçari në Mat! Në

Report TV



Watch on

Redaksia 29 Gusht, 10:41 | Përditësimi: 29 Gusht, 10:47

Share Post WhatsApp



MAT- Një 67-vjeçar është arrestuar në Burrel, pasi dyshohet se ka dhunuar dhe kërcënuar bashkëshorten e tij.

Policia u njoftua për një konflikt në familje dhe mbërriti në banesën e çiftit, ku ndërhyri për të parandaluar përshkallëzimin e situatës.

Gjatë kontrollit në banesë policia gjeti një armë zjarri automatik, dy krehra dhe 55 fishekë, të cilat u sekuestruan.



LEXO EDHE: Zjarret/ 5 vatra aktive në vend! Situatë më problematike në Dajt, u ndërhy me 2 helikopterë! Në Vajkal të Bulqizës djegin sipërfaqe të mëdha me shkurre e dëllinja

“Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat, pas marrjes së njoftimit për një konflikt familjar në një banesë në qytetin e Burrelit, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje.

Falë ndërhyrjes së menjëhershme dhe në kohë të shërbimeve të Policisë, situata është neutralizuar dhe është parandaluar përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit, duke shmangur një ngjarje potencialisht të rëndë kriminale.

Si rezultat, u arrestua në flagrancë shtetasi B. K., 67 vjeç, banues në qytetin e Burrelit, pasi nga verifikimet e kryera ka rezultuar se ky shtetas kishte dhunuar dhe kanosur bashkëshorten e tij”, njofton Policia.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Diber, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

SLE./E.H/Shqiptarja.com

TAG: Mat Diber

Sa e vlerësoni këtë artikull?

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës: Si ju duket plani i qeverisjes i paraqitur në Pogradec nga Rama?

24 Gusht, 21:21

Mirë Keq Nuk e di

Lajme të tjera



Zjarr masiv pranë fshatit Muzhakë të Matit, flakët përhapen me shpejtësi në një sipërfaqe me dushqe (VIDEO)

28 Gusht, 21:12



Zjarri në fshatin Vajkal të Bulqizës, identifikohet autori i dyshuar i zjarrvënies! Nisin hetimet në gjendje të lirë për 49-vjeçarin (VIDEO)

28 Gusht, 18:04



Bulqizë/ Portat e HEC-it të Maqedonisë së Veriut u hapën kur po laheshin në Drin, uji merr xhaxhain me 2 nipat e 2 mbesat! Mbytet 7-vjeçarja! Prefektura: S'ka orare të caktuara për shkarkimet

Mahir Jangulli

28 Gusht, 08:51



Helikopteri i Forcës Ajrore në aksion për shuarjen e zjarrit në Vajkal, vijon operacioni nga ajri (VIDEO)

27 Gusht, 16:12




Zjarret, 5 vatra ende aktive! Problematike mbeten Dajti dhe Dibra, në operacion edhe dy helikopterë të Forcave të Armatosura

27 Gusht, 09:52



Zjarr mbi Vajkal të Bulqizës, dyshohet i qëllimshëm (VIDEO)

27 Gusht, 09:22



Policia zbulon dy parcela me 215 bimë kanabisi në Bulqizë, arrestohet 37-vjeçari nga Kamza (EMRI+VIDEO)

26 Gusht, 12:53



‘Territorialja’/ Demokratët kërkesë Këshillit Bashkiak: Nisni dëgjuesat në Tiranë! Banorët e Klosit: Jo bashkim me Matin! PS e PD përplasen në Elbasan

25 Gusht, 13:19



Kundërshtoi me dhunë efektivët gjatë kontrollit të makinës, arrestohet 30-vjeçari në Dibër

Mahir Jangulli

25 Gusht, 13:04



Shkolla ‘Abdyrrahman Përmeti’ në Lis të Matit gati për vitin e ri shkollor! Rama: Investim i rëndësishëm për fëmijët dhe komunitetin (FOTO)

25 Gusht, 12:42



Zjarret në vend, 6 vatra aktive! Vijon operacioni në Malin e Dajtit, flakët 'përpijnë' hapësira të mëdha në Shashicë të Vlorës! 'Qetësohet' Puka

25 Gusht, 09:32



Tingulli që bashkon fetë, historia e rrallë nga Lura e myslimanit që kujdeset për kishën! Luan Doçi: E bëj për sevap (VIDEO)

Armir Mehaj

23 Gusht, 15:52



Shqiptarja.com Lajmi i fundit

Kosovë/ Kurti takohet sërish me Abdixhikun, nuk ka dakordësi për Presidentin! Kreu i LVV: Kur të kemi rezultate, do të ketë edhe lajme!

29 Gusht, 23:01



×

Sh

.com

Lajmi i fundit



Kosovë/ Kurti takohet sërish me Abdixhikun, nuk ka dakordësi për Presidentin! Kreu i LVV: Kur të kemi rezultate, do të ketë edhe lajme!

29 Gusht, 23:01